



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.721/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Faton Bajrami dhe Saranda Bogaj Sheremeti, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Lahu shpk me seli në fshatin Qabër Komuna Zubin Potok, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Irfan Zhushi avokat nga Vushtria, kundër të paditurës Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencia Pyjore e Kosovës, me seli në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës–Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, K.A.nr.245/23 të datës 31.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 29.05.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e paditësit Lahu shpk me seli në fshatin Qabër Komuna Zubin Potok, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, K.A.nr.245/23 i datës 31.01.2024, VËRTETOHET

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, K.A.nr.245/23 të datës 31.01.2024, është Refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit Lahu shpk me seli në fshatin Qabër Komuna Zubin Potok, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi KE-669/14 i datës 31.07.2014 i nxjerr nga i padituri Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencia Pyjore e Kosovës.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë paditësi, për shkak të: shkeljeve thelbësore të dispozitave ligjore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që ankesa e paditësit të aprovohet, të anulohet aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, K.A.nr.245/23 i datës 31.01.2024

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se në procedurën administrative të ankesave, e paditura Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencia Pyjore e Kosovës me seli në Prishtinë, me vendimin përfundimtar Ref: KE-669/14 date 31.07.2014, ka Refuzuar kërkesën e paditësit si të pabazuar, për vazhdimin e afatit për dorzimin e dokumentacionit dhe për vazhdimin e kontratës Ref;KE-375/09 dates 30.06.2009 për ndërrimin e destinimit dhe shfrytëzimin e perkohshëm të tokës pyjore me qira.

Paditësi i Lahu shpk me seli në fshatin Qabër Komuna Zubin Potok, I pakënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës MBPZHA-Agjencia Pyjore e Kosovës ka ushtruar padi për konflikt administrativ në gjykatë, me pretendimin se vendimi i të paditurës është i pa drejtë dhe i paligjshëm.

Dhomat e shkallës së parë pas shqyrtimit të padisë së paditësit të paraqitur kundër vendimit të paditures MBPZHA-Agjencia Pyjore e Kosovës, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor datës 22.01.2024, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e refuzon si të pa bazuar. Me arsyetimin se e paditura kishte vertetuar drejt gjendjen faktike me rastin e vendosjes lidhur me kerkesen e padiësit per vazhdimin e kontratës, pasi që kërkesa e paditësit ka qenë e pakompletuar, duke qenë se të njëjtës i kanë munguar dokumentacionet si: certifikata e biznesit, numri fiskal i veprimtarisë, vërtetimi i ATK-së, fleta poseduese me kopjen e planit të paluajtshmërisë, pëlqimi komunal, kopjen e letërnjoftimit si dhe nuk kishte përmbushur obligimet financiare ndaj të paditurit. Gjykata e vleron të drejt veprimin e te paditures në zbatim të nenit 4 par.3 të Udhëzimit Administrativ nr.41/2006 për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore, andaj vleron se e paditura me të drejt ka refuzuar kërkesën e paditësit pasi që i njëjti nuk kishte plotësuar kushtet për vazhdimin e kontratës duke mos ofruar dokumentacionin e nevojshëm.

Qëndrimin juridik të Dhomës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, Dhoma e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë i'u ka referuar dispozitave ligjore të Ligjit Nr.02/L-26 për Tokën Bujqësore, dhe Udhëzimit Administrativ 41/2006 për Ndërrimin e Destinimit të Tokave Bujqësore.

Kolegji i Dhomave të shkallës së dytë, në këtë konflikt administrativ, vleron se palët ndërgjyqse kanë lidhur Kontratën per shfrytëzimin e tokës pyjore nr.KE 374/09, per periudhen kohore prej 5 vitesh, me mundesin e vazhdimit me anex kontrate edhe per një kohe te caktuar. E paditura përmes vërejtjeve me shkrim shkrim dt.26.07.2013, 16.12.2013 27.06.2013 ka kërkuar nga paditësi përmbushjen e obligimeve te mbetura sipas kontrates, ndersa paditësi i drejtohet te paditures me kërkes per vazhdimin e kontratës për shfrytëzimin e tokës pyjore me qira, dhe kërkesën për vazhdimin e afatit për dorzimin e dokumentacionit për vazhdimin e kontratës dt.27.06.2014. Kolegji vleroi se gjykata e shkallës së parë me të drejt ka refuzuar kërkesëpadinë e

paditësit per anulimin e vendimit kontestues te paditurit, pasi që paditësi nuk ka vepruar sipas rekomandimeve të paditures dhe nuk ka dorzuar dokumentacionin e kompletuar që kërkohet me dispozitat e nenit 3.3 të Udhëzimit Administrativ nr.41/2006 për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje thelbësore të dispozitave nga neni 182.2 pika (g,k dhe n) të LPK-së, dhe se gjykata e shkallës së parë nuk e ka shqyrtuar në mënyrë reale gjendjen faktike, se e paditura ka shkel ligjin kur ka nënshkruar kontrate me Mani Com shpk, dhe se i tërë dokumentacioni ka qen në dispozicion të paditurit, dhe e njëjta me asnjë shkrese nuk ka kërkuar që paditësi të dorzoj dokumentet përkatëse, Kolegji i Dhomës së shkallës së dytë, nuk i aprovoi këto pretendime si të bazuara ndërsa aktgjykimi i ankimuar i Dhomës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij i janë dhënë arsyet të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Kolegji vlersoi se gjatë procesit administrativ të udhehequr nga e paditura, e cila në këtë rast ka kërkuar nga paditësi përmbushjen e obligimeve të mbetura sipas kontratës nr.KE 374/09, sipas vërejtjeve datës 26.07.2013 dhe 16.12.2013, nuk mund të pranohen si të bazuara pretendimet se gjykata e shkallës së parë ka nxjerr aktgjykim bazuar në disponimin e palejueshem të palëve apo se ka marr pjes personi që nuk mund të jetë palë në procedurë. Kolegji vlersoi se procesi administrativ nga e paditura është udhehequr ndaj kompanis Lahu shpk me seli në Mitrovicë të cilën e përfaqëson Naser Lahu, dhe i njëjti person ka ngrit padi në konflikt administrativ pranë gjykatës.

Edhe Kolegji i Dhomave të shkallës së dytë, i vleron si të drejta dhe të bazuara vendimet e të paditurit dhe Dhomës së shkallës së parë, pasi që paditësi nuk ka argumentuar pretendimet ankimore në drejtim të përmbushjes se obligimeve kontraktuese, për t,iu vazhduar afati për vazhdimin e kontratës për shfrytëzimin e tokës pyjore me qira, dhe në anën tjetër paditësi nuk ka përmbushur obligimet ligjore për kompletimin e dokumentacionit të kërkuar nga neni nenit 3.3 të Udhëzimit Administrativ nr.41/2006 për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore.

Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se nuk kemi vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, apo aplikim të gabuar të drejtës materiale, sikurse pretendon në ankes paditësi, dhe se arsyetimi i dhomës së shkallës së parë është i drejt, i ligjshëm dhe i mbështetur në prova dhe fakte, pasi që dhoma e shkallës së parë e ka arsyetuar vendimin e saj duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Dhomat e Shkallës së Dytë i shqyrtoi edhe pretendimet e tjera të palës ankuese në ankesë mirëpo, të njëjtat ishin të pa bazuara dhe nuk kishin ndonjë ndikim në vendosje ndryshe, andaj edhe vendosi që aktgjykimin e shkallës së parë ta vërteton si të drejtë dhe të ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, lidhur me nenin 49 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.721/24 datë 29.05.2024

Kryetar i kolegjit,
Krenar Berisha